

Përmiresimi i Mekanizmave të Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve në Rajonin e Ballkanit Perëndimor

Korrik 2021



Ky raport studimi mbi mekanizmin e monitorimit të të drejtave të fëmijëve në rajonin e Ballkanit Perëndimor, u përgatit nga “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve”, në bashkëpunim me “Rrjetin për Organizatën e Grave Romë, Ashkali dhe Egjiptiane në Kosovë (NRAEWOK)” dhe “Qendra Maqedonase për të Drejtat e Grave - Strehëza” në Maqedoninë e Veriut si dhe me mbështetjen e Western Balkans Fund (WBF). Opinonet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të ekipit të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Western Balkans Fund.

@ Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

Tiranë, Korrik 2021

Ndalohet shitja apo përdorimi i këtij raporti për qëllime përfitimi.

Lutemi citojeni këtë publikim si: “Raporti mbi mekanizmin e monitorimit të të drejtave të fëmijëve në rajonin e Ballkanit Perëndimor” përgatitur nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, me mbështetjen e Western Balkans Fund (Korrik, 2021)”.

Falenderime

Ky raport është përgatitur nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori), në bashkëpunim me “Rrjetin për Organizatën e Grave Romë, Ashkali dhe Egjiptiane në Kosovë (NRAEWOK)” dhe “Qendra Maqedonase për të Drejtat e Grave - Strehëza” në Maqedoninë e Veriut. Falenderojme ekipin e ekspertëve, ndër të cilët znj. Ensara Reçi.

Një kontribut të vecantë ka dhënë dhe znj. Elma Tërshana, drejtore e Observatorit për mbështetjen e saj strategjike si dhe në lehtësimin e vazhdueshëm për të realizuar hapat e studimit

Financimi

Ekipi i ekspertëve shpreh mirënjohjen për “Western Balkans Fund” për financimin e nismës “Përmirësimi i mekanizmave të monitorimit të të drejtave të fëmijëve në rajonin e Ballkanit Perëndimor”

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, është një nga organizatat partnere me WBF, e cila ka zbatuar një nismë rajonel. Observatori e vlerëson këtë nismë të financuar nga WBF si një mundësi bashkëpunimi rajonal jashtëzakonisht të rëndësishëm për të çuar përpara proceset e pajtimit mes vendeve të Ballkanit.

Objektivi i përgjithshëm i kësaj nisme është të kontribuojë në bashkëpunimin rajonal dhe të forcojë kohezionin social mes vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6). Objektivi specifik i kësaj nisme është prezantimi dhe mundësia e përrthithjes së eksperiencës dhe modelit të punës vëzhguese dhe monitoruese të Observatorit në dy vende partnere të rajonit: Maqedonia e Veriut dhe Kosova*; Si dhe rritja e njohurive dhe aftësive të aktivistëve të OSHC-ve në lidhje me aksesin në informacion mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve. Përmes këtij bashkëpunimi ne synojmë të zgjerojmë përvojën tonë në agendën për të drejtat e fëmijëve në rajon.

Puna jonë si strukturë vëzhguese, e bazuar në nivelin lokal është “një dorë e zgatur nga ana e shoqërisë civile” për politikëbërësit në nivelin qendror, rajonal dhe lokal, si dhe në interes të zyrtarëve publikë që janë të angazhuar në procese të zbatimit të të drejtave të fëmijëve. Zbatimi i kësaj nisme ishte dhe prezantimi dhe ndarja e përvojës së suksesshme të Observatorit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor duke bashkëpunuar ngushtë me “Rrjetin për Organizatën e Grave Romë, Ashkali dhe Egjiptiane në Kosovë (NRAEWOK)” dhe “Qendra Maqedonase për të Drejtat e Grave - Strehëza” në Maqedoninë e Veriut. Ne besojmë fuqimisht në bashkëpunimin tonë me NRAEWOK në Kosovë, duke iu referuar gjithashtu dhe grupit me të cilin punon kjo organizatë që janë fëmijë që braktisin shkollën në Kosovë kryesisht nga komunitetet Romë, Ashkalinj dhe Egjiptianë; evidentohet që autoritetet locale dhe qendrore në Kosovë nuk kanë të dhëna në lidhje me frekuentimin dhe cilësinë e të nxënësve të këtyre fëmijëve. Ndërsa, bashkëpunimi i ngushtë me “Qendrën Maqedonase për të Drejtat e Grave - Strehëza” ka të bëjë me leximin e të dhënave lokale dhe kombëtare për situatën e fëmijëve në Maqedoni, duke iu referuar dhe bazuar pikërisht në marrëdhëniet dhe historinë e bashkëpunimit që “Strehëza” ka konsoliduar për të drejtave të grave dhe familjes në Maqedoninë e Veriut. Ne besojmë se iniciativa jonë me përfshirjen e shumë ekspertëve të ndryshëm në rajonet e Ballkanit, mund të jetë një pikënisje për të shtyrë përpara dhe zgjeruar më tej këtë iniciativë dhe në vendet e tjera të rajonit.

Bashkëpunimi rajonal qëndron në themel të gjithë strukturës së Bashkimit Evropian dhe është një model bashkëpunimi i suksesshëm, veçanërisht në një mjedis kaq të larmishëm siç është Evropa. Vendet që dikur ishin pjesë e një shteti dhe tashmë janë vende fqinje të lidhura historikisht dhe gjeografikisht me njëra-tjetrën, vendet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë zgjidhje tjetër përveç bashkëpunimit ndërmjet tyre. Për më tepër, të gjitha këto vende konsiderohen të vogla në mbulimin e tyre territorial, popullsinë, ekonominë dhe burimet; vlerësohet në interesin më të mirë të të gjithë vendeve që të bashkojnë potencialet e tyre dhe të veprojnë si partnerë rajonalë, sesa lojtarë individualë.

Miratimi i standardeve evropiane, me një qasje nga lart-poshtë, vazhdon të mbetet me ndikim thelbësor ku të gjithë palët e interesuara të jenë të përfshira. Duke qenë se në Shqipëri, Observatori ka arritur të konsolidojë një eksperiencë të suksesshme dhe të qëndrueshme duke vazhduar të jetë një agjent, partner dhe një avokat i rëndësishëm me autoritetet lokale dhe qendrore për të ngritur dhe zhvilluar masat dhe

* Ky emërtim nuk paragjykon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e ICJ për deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

aksionet lokale për të adresuar nevojat e fëmijëve dhe familjeve, veçanërisht të grupeve në nevojë, - i jep besueshmëri kësaj nisme, ku iniciativa të ngjashme mund të jenë të suksesshme dhe në vendet e tjera të rajonit.

Në të tre vendet e Ballkanit Perëndimor, pjesë e kësaj nisme, vazhdojmë të përballemi me martesat e hershme dhe kjo vjen si rezultat i ekonomisë së dobët, ndër të tjera. Organizatat në rajon si NRAEWOK kanë kryer projekte të segmentuara në lidhje me: identifikimin e shkaqeve që nxisin dhe faktorëve që e lejojnë martesat e hershme; e lidhur kjo dhe me efektet e saj në çështjen e sigurisë dhe mbrojtjes së të miturve nga realizimi i martesave të mitura për trafikim, shfrytëzim ose ndonjë formë tjetër abuzimi, etj. Por duke pasur projekte të segmentuara dhe me fonde të kufizuara, bën që këto çështje të mbeten të pa zhvilluara më tej, duke evidentuar ndër të tjera mos prezencën e mekanizmave lokal dhe kombëtar për parandalimin dhe ndjekjen e rasteve. Bazuar në punën shumë vjecare të Observatorit, i cili përmes një bashkëpunimi të ngushtë me shumë institucione dhe aktorë ka arriti të bëhet pjesë e promovimit dhe ndërtimit të aksioneve drejtuar vajzave adoleshente me qëllim vazhdimin e një jete me dinjitet dhe larg martesave të hershme. Deri më tani, bashkëpunimi me Observatorin ka qenë i suksesshëm dhe me angazhime konkrete. Ndikimi i vërtetë i kësaj iniciative është të sjellë nevojën për të dy vendet se një mekanizëm si Observatori Shqipëri është i nevojshëm dhe në vendet e tjera.

Në kuadër të kësaj nisme u realizua dhe një dokument teknik për ndarjen e eksperiencave. Agenda e mentorimit në këtë nismë ishte programi i *mentorimit mes kolegëve* ose *programi i mentorimit për të njëjtin nivel ekspertize*. Kjo do të thotë që të gjithë pjesëmarrësit në këtë program janë profesionistë në fushën e tyre të punës dhe qëllimi final i mentorimit ishte shkëmbimi i informacionit dhe mbledhjes së të dhënave midis institucioneve brenda vendit dhe shkëmbimi i informacionit në nivelin rajonal. Nëntë (9) tregues u zgjodhën për tu mbledhur me të dhëna nga të 3 vendet e Ballkanit, me përfshirjen e 2 komunave/ njësisve administrative të ndryshme për secilin vend. Përmes këtyre treguesve kemi vërejtur se cili është procesi i mbledhjes së të dhënave në 3 vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu, u zhvilluan trajnime me OSHC dhe aktivistë nga këto vende partnere.

SHQIPËRIA

Të drejtat e fëmijëve janë gjithmonë çështje me prioritet dhe ndjeshmëri të lartë për shoqërinë dhe institucionet e një vendi. *Një qeverisje e mirë për fëmijët*, ndër të tjera duhet të adresojë shkaqet themelore të mungesës së reagimit të sektorit publik ndaj fëmijëve. Vendi për të shqyrtuar cilësinë e qeverisjes së mirë nga këndvështrimi i fëmijëve është në pikat e kontaktit midis fëmijëve dhe shtetit.


Mbrojtja dhe promovimi i mirëqenies së fëmijëve nuk është thjesht një domosdoshmëri morale, por edhe një çështje pragmatike. Mos arritja për ta bërë këtë mund të shkaktojë rreziqe në rritje në një gamë të gjerë rezultatesh më vonë gjatë jetës së fëmijës, si dhe atë të komuniteteve dhe vendeve të tyre.

Qeveria shqiptare ka ndërmarrë dhe po zbaton një reformë të gjerë dhe komplekse në politikën sociale, që synon forcimin e mekanizmave institucionalë për të monitoruar dhe raportuar mbi realizimin e të drejtave të fëmijës. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), ratifikuar nga Shqipëria në Mars 1991, udhëzoi reformën në ligj dhe çoi në miratimin e Ligjit Nr. 10347, datë 4.11.2010, 'Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve'. Ky ligj hedh themelin për krijimin e institucioneve efektive për të siguruar që të drejtat e të gjithë fëmijëve mbrohen dhe respektohen nga individët, familjet dhe shteti. Pavarësisht nga arritjet, është veçanërisht e rëndësishme të sigurohet që ligjet specifike janë pjesë e këtij Ligji integral, ndërsa politikat sociale dhe strategjitë përkatëse janë gjithë përfshirëse.

Të dhënat kryesore të raportit për Shqipërinë janë prodhuar nga institucione publike qendrore dhe lokale, të tilla si Instituti Kombëtar i Statistikave (INSTAT), Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Instituti i Shëndetit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, si dhe institucionet në varësi të këtyre institucioneve qendrore në nivel lokal dhe Bashkitë.

Mekanizmat institucionalë për të drejtat e fëmijëve në Republikën e Shqipërisë janë si më poshtë:

- 1- Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë janë:
 - Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në nivel qendror;
 - grupi teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative në nivel vendor.
- 2- Strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror janë:
 - ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;
 - Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
 - çdo ministër përgjegjës, sipas fushës që mbulon, në lidhje me të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.
- 3- Strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë:



- bashkia;
- struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;
- njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;
- njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësive administrative;
- punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe Rinisë zgjodhi si bashki për mbledhjen e të dhënave bashkia e Shkodrës, duke përfaqësuar pjesën veriore të Shqipërisë dhe Bashkia e Korçës, - duke përfaqësuar pjesën juglindje të Shqipërisë.

1. Bashkia e Shkodrës, në historinë e saj njihet dhe si Scodra ose Scutari, I cili është qyteti i pestë më i populluar i Republikës së Shqipërisë. Shkodra një nga qytetet më të lashta në Ballkan, I cili ushtron ndikime në kulture, ekonomi dhe fesë në pjesën veriore të vendit. Popullsia totale është 135,612 (regjistrimi i popullsisë 2011), në një sipërfaqe totale prej 911,84 km² (352,06 milje katrore).
2. Korça është qyteti i tetë më i populluar i Republikës së Shqipërisë. Popullsia e përgjithshme është 75,994, në një sipërfaqe totale prej 806 km².

Për ta bërë procesin e mbledhjes së të dhënave të krahasueshme midis vendeve partnere në këtë projekt, u realizuan 3 pyetje.

- Si ishte procesi i mbledhjes së të dhënave në lidhje me treguesit për të drejtat e fëmijëve? Cilat ishin vështirësitë dhe pengesat që ju u ballafaqat?

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjtë realizoi disa vizita dhe takime në terren, në bashkitë përkatëse të projektit, për të bërë të mundur mbledhjen e të dhënave për treguesit e synuar. Vumë re që të dhënat që ne intersoheshim për ti mbledhur nga institucionet locale (shëndet, mbrojtje sociale dhe arsim) nuk ishin pjesë e informacionit public në faqet e internetit përkatës të institucioneve. Duke qenë se Observatori ka një eksperiencë të gjatë investimi në cështjen e të dhënave të fëmijëve, një pjesë e të dhënave nga vitet e më parshme u bazuar në databankën e Observatorit. Për shkak të situatës pandemike si në vend dhe në gjithë rajonin, procesi i mbledhjes së të dhënave hasi në vështirësi dhe vonesa për shkak të përgjigjeve të vonuara nga institucionet përkatëse lokale.

- Si po funksionon mekanizmi i mbrojtjes së fëmijëve në vendin tuaj?

Mekanizmi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë ndër vite ka arritur të realizojë hapa të suksesshëm, por ndërkohë evidentohen akoma cështje në nivel lokal për të adresim më të drejtë për drejtë, sic është: evidentimi që në fillim të vitit shkollor të fëmijëve jashtë shkolle, mirë adresimi I rasteve në risk të martesave të hershme, marrja e masave të menjëhershme të rasteve të trafikimit apo shfrytëzimit për punë apo për lypje të fëmijëve, e shumë cështje të tjera. Evidentojmë që në shumicën e institucioneve në nivel lokal, mbahen statistika të hollësishme për të dhënat që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve. Por vihet re që vazhdon akoma të ketë mungesa raportimi dhe dokumentimi në lidhje me treguesit që janë të ndarë sipas grupmoshave, gjinisë, vulnerabilitetit, vendbanimit, etj.

- Cili mund të jetë roli i OShC-ve në përmirësimin e mekanizmit për të drejtat fëmijën?

Misioni i Observatorit është të sigurojë dinjitetin dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve në të gjithë Shqipërinë përmes vëzhgimit, hulumtimit dhe analizës, komunikimit dhe avokimit, duke bashkëpunuar me palët e tjera të interesit / institucionet; dhe duke përfshirë fushatat e ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut. Përmes përfaqësuesve të tij në nivelin rajonal dhe në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore në bashki dhe njësi administrative, Observatori zotëron informacione statistikore nga të dhënat administrative të shëndetit, arsimit, mbrojtjes sociale dhe autoriteteve të tjera lokale.

OShC-të mund të nxisin dhe monitorojnë institucionet shtetet për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe mund të avokojnë për ndryshime pozitive për fëmijët në politikat, ligjet, programet dhe buxhetet në nivel qendror dhe lokal. Ai gjithashtu mund të promovojë, ndërgjegjësojë dhe ndërtojë kapacitete mbi të drejtat e fëmijëve. Në shumë vende, shoqëria civile ndihmon në ofrimin e shërbimeve themelore për fëmijët dhe gjithashtu mund të jetë një vëzhgues për të siguruar qasje të barabartë në shërbime dhe standarde të përshtatshme të cilësisë në vazhdimësi të zhvillimit dhe konteksteve humanitare.

Shoqëria civile mund të mbështesë pjesëmarrjen e vajzave dhe djemve në qeverisje si qytetarë aktivë dhe agentë për ndryshime pozitive në shoqëri. Mundësitë e fëmijëve për të përmirësuar jetën dhe për të drejtuar axhendat e tyre, janë të lidhura me forcën dhe diversitetin e shoqërisë civile e cila në rastin më të mirë ofron mundësi të shumta për vetë-shprehje, dialog dhe shkëmbim për fëmijë dhe të rritur. Është thelbësore që të kemi hapësira dhe vende të ndryshme ku njerëzit, përfshirë fëmijët, mund të bashkohen për të argumentuar në mënyrë konstruktive, për të gjetur pikat e mundshme të konsensusit dhe për të punuar kolektivisht. Ky vizion pluralist është i mundur vetëm kur ka një gamë të gjerë të organizatave të shoqërisë civile, lëvizjeve dhe individëve që janë në gjendje të veprojnë lirshëm. Fëmijët kanë të drejtë të dëgohen, ata duan të dëgohen dhe ne kemi nevojë që ata të flasin për të kuptuar më mirë dhe për t'u përgjigjur situatës së tyre.

Të drejtat e fëmijëve janë të drejta në kuadër të të drejtave të njeriut me vëmendje të veçantë ndaj të drejtave të mbrojtjes dhe kujdesit të veçantë që u jepen të miturve. Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve janë ngritur një sërë mekanizmash institucional në nivel global, rajonal, qendror dhe vendor. Organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe promovimin efektiv të të drejtave të fëmijëve. Ndërsa mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës synojnë t'i ofrojnë fëmijës një mjedis të sigurtë dhe shërbimet e nevojshme për garantimin e mirëqenies, organizatat e shoqërisë civile janë promotor dhe nxitës së zbatimit të angazhimeve në funksion të drejtave të fëmijëve. Roli dhe puna e organizatave të shoqërisë civile është shumë e rëndësishme në fushën e të drejtave të fëmijëve, duke monitoruar dhe bashkëpunuar ngushtësisht në fushën e ndërgjegjësimit, lobimit dhe advokimit me aktorët përgjegjës për realizimin dhe garantimin e mbrojtjes së fëmijëve. Shoqëria civile punon ngushtësisht me komunitetin dhe është përcjellëse e nevojave të tyre tek organet vendimmarrëse dhe politikëbërëse. Nëpërmjet punës në komunitet dhe dëgjimit të zërit të fëmijëve, shoqëria civile punon me fëmijët dhe me gjithë grupin e aktorëve që ndikojnë në jetën e tyre, si prindërit, mësuesit, mjekët, psikologët, punonjësit social, punonjësit e njësisë për mbrojtjen e fëmijëve etj.

KOSOVA

Rrjeti i Organizatave të Grave Romë, Ashkali dhe Egjiptiane në Kosovë (NRAEWOK) si pjesë e ekipit rajonal të nismës “Përmirësimi i mekanizmave të monitorimit të të drejtave të fëmijëve në rajonin e Ballkanit Perëndimor” të udhëhequr nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, dhe i financuar nga WBF, vlerësohet si një nismë e rëndësishme për të çuar përpara proceset e pajtimit rreth Ballkanit. Përmes këtij bashkëpunimi, NRAEWOK ndjehet besimplotë tashmë, se si një strukturë vëzhguese, bazuar në nivelin lokal është një dorë e zgjatur për shoqërinë civile, politikëbërësit në nivelin qendror, rajonal dhe lokal; si dhe nxit dhe vlerëson interesin e zyrtarëve publikë që janë në linjën e parë të ofrimit të shërbimeve, në lidhje me përmbushjen e të drejtave të fëmijëve. NRAEWOK përmes iniciativave të tjera arriti të gjurmtojë një numër të madh të fëmijëve që kanë braktisur shkollën në Kosovë të cilët kryesisht janë fëmijët nga komunitete Romë, Ashkali dhe Egjiptian; Gjithashtu evidentohet që dhe autoritetet lokale nuk kanë të dhëna në lidhje me cilësinë e të nxënit (gjendjen e shkrim-leximit) të këtyre fëmijëve; Falë kësaj nisme, NRAEWOK beson se mund ta fuqizojë rolin e saj si avokate nevojave të paadresuara të fëmijëve dhe familjeve (kryesisht nga grupet e marginalizuara), me autoritetet qeveritare në nivel qendror dhe lokal.



Mekanizmat institucionalë për të drejtat e fëmijëve në Republikën e Kosovës janë si më poshtë:

1. Struktura institucionale dhe mekanizmat në nivelin qendror janë:
 - Avokati I Popullit
 - Ministritë përkatëse sipas fushës që mbulojnë, në lidhje me të drejtat e fëmijës;
 - Njësia përkatëse për qeverisje të mirë, brenda Zyrës së Kryeministrit;
 - Komiteti Ndërmnistor për të Drejtat e Fëmijëve;
 - Këshilli për të Drejtat e Fëmijëve;
2. Struktura institucionale dhe mekanizmat në nivelin lokal janë:
 - Bashkia;
 - Departamenti përkatës sipas fushës që mbulojnë në lidhje me të drejtat e fëmijës;
 - Qendra për punë sociale;
 - Skuadra për të drejtat e fëmijës;

NRAEWOK kreu një hulumtim në dy komuna, që janë:

1. Komuna Ferizaj, - e cila ndodhet në jug-lindje të Kosovës, ndërmjet Prishtinës dhe Shkupit, Maqedonisë së Veriut, dhe
2. Komuna e Shtimes, e vendosur në Rrethin e Ferizaj të Kosovës.

Komuna e Ferizaj, për sa i përket popullsisë është mjaft e pasur me komunitete të minorancave të ndryshme, ku:

- Në masën 95% donimon komuniteti Shqiptar,
- Komuniteti Serb është 1,7% dhe
- Komuniteti Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët përbëjnë rreth 2,5%.

Bashkia e Shtimes ka 7,225 banorë, ndërsa komuna (rajoni) ka 27,324 banorë. Në lidhje me etninë e komuniteteve të kësaj zone, kemi:

- Komuniteti shqiptar përbën 96.8% të popullsisë së zonës,
- Komuniteti serb përbën 0,18% dhe
- Komunitetet Romë, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët përbëjnë 2,8% të popullsisë së përgjithshme në Shtime.

- Si ishte procesi i mbledhjes së të dhënave në lidhje me treguesit për të drejtat e fëmijëve? Cilat ishin vështirësitë dhe pengesat që ju u ballafaquat?

NRAEWORk u përballë me disa pengesa në mbledhje me mbledhejn të dhënave për shumicën e indikatorëve dhe këto pengesa u përballën më shumë në Komunën e Shtimes, - ku për disa tregues të dhënave nuk u arrit që të mbledheshin. Me gjithë këmbënguljen e stafit të angazhuar të NRAEWORk në këtë nismë për të patur një përgjigje institucionale mos dhënien e një përgjigje në lidhje me këto tregues të munguar, ne akoma dhe sot nuk kemi një komunikim zyrtar me arsyen pse këto të dhëna nuk jepen apo grumbullohen nga institucionet e Komunës së Shtimës.

- Si po funksionon mekanizmi i mbrojtjes së fëmijëve në vendin tuaj?

Mekanizmi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Republikën e Kosovës është zhvilluar shumë deri më tani dhe ende po punon për avancimin e tij të mëtejshëm. Në shumicën e institucioneve, mbahen statistika për të dhënat që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve. Sidoqoftë, ende mungojnë një numër i madh i të dhënave që mungojnë informacione dhe të dhëna numerike në lidhje me moshën, gjininë, vulnerabilitetin, etj

- Cili mund të jetë roli i OShC-ve në përmirësimin e mekanizmit për të drejtat fëmijën?

Shoqëria civile mund t'u kërkojë llogari shteteve për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe mund të mbrojë ndryshime pozitive për fëmijët në politika, ligje, programe dhe buxhete. Ai gjithashtu mund të promovojë, ndërgjegjësojë dhe ndërtojë kapacitete mbi të drejtat e fëmijëve. Në shumë vende, shoqëria civile ndihmon në ofrimin e shërbimeve themelore për fëmijët dhe gjithashtu mund të jetë një vëzhgues për të siguruar qasje të barabartë në shërbime dhe standarde të përshtatshme të cilësisë në vazhdimësinë e zhvillimit dhe konteksteve humanitare. Shoqëria civile mund të mbështesë pjesëmarrjen e vajzave dhe djemve në qeverisje si qytetarë aktivë dhe agjentë për ndryshime pozitive në shoqëritë e tyre. Mundësitë e fëmijëve për të përmirësuar jetën e tyre dhe për të drejtuar axhendat e tyre janë të lidhura me forcën dhe diversitetin e shoqërisë civile e cila në rastin më të mirë ofron mundësi të shumta për vetë-shprehje, dialog dhe shkëmbim për fëmijë dhe të rritur.

MAQEDONIA E VERIUT

Qendra Maqedonase për të Drejtat e Grave - Strehëza si pjesë e ekipit rajonal të nismës “Përmirësimi i mekanizmave të monitorimit të të drejtave të fëmijëve në rajonin e Ballkanit Perëndimor” të udhëhequr nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, dhe i financuar nga WBF, vlerësoi këtë nismë si një mundësi të rëndësishme për të unifikuar mbledhjen e të dhënave për fëmijët në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Mekanizmi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut është zhvilluar shumë deri më tani dhe ende po punon për avancimin e tij të mëtejshëm.



Ligji që merret me të drejtat e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut është Ligji për të Drejtat e Fëmijëve. Ky ligj u miratua për herë të parë në 2013, dhe në 2019 ka pësuar ndryshime mbi trajtimin e fëmijëve në rrezik dhe fëmijëve shkelës të ligjit, përcakton kushtet për aplikimin e masave të ndihmës, kujdesit dhe mbrojtjes, masat edukative dhe alternative dhe ndëshkimin e fëmijëve dhe të rinjve, pozicioni, roli dhe kompetenca e organeve që marrin pjesë në trajtimin e fëmijëve dhe ekzekutimin e masave dhe dënimeve edukative dhe alternative.

Qëllimet e Ligjit për të Drejtat e Fëmijëve janë realizimi i interesit prioritar dhe mbrojtja e fëmijëve nga krimi, dhuna dhe çdo formë e rrezikimit të lirive dhe të drejtave të tyre, mbrojtja e fëmijëve autorë të vepra penale, socializimi dhe riedukimi i tyre, ndihma dhe kujdesi për fëmijët dhe mbrojtja në procedurat gjyqësore dhe organet e tjera të lirive dhe të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare për pozicionin e fëmijëve, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mekanizmat institucionalë për të drejtat e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë si më poshtë::

- Qendra për Çështje Sociale;
- Ministria e Brëndshme; and
- Gjykatat - gjykata ka një gjykatës për fëmijë dhe këshill për fëmijë;
- Prokuroria;
- Institucionet për ekzekutimin e sanksioneve për fëmijët.

Qendra Maqedonase për të Drejtat e Grave - Strehëza kreu një hulumtim në dy bashki, që janë:

1. . Shkupi kryeqyteti dhe qyteti më i madh i Maqedonisë së Veriut. Ka një popullsi prej 428,988 banorë në zonën e tij urbane dhe 506,926 në dhjetë komuna që formojnë qytetin.

2. Bashkia e Gjevgelije e vendosur në juglindje të Maqedonisë së Veriut përgjatë brigjeve të lumit Vardar, i vendosur në kufirin kryesor të vendit me Greqinë. Ka një popullsi prej 15,685 banorë.

- Si ishte procesi i mbledhjes së të dhënave në lidhje me treguesit për të drejtat e fëmijëve? Cilat ishin vështirësitë dhe pengesat që ju u ballafaquat?

Qendra Maqedonase për të Drejtat e Grave - Strehëza nuk u ndeshën me ndonjë pengesë serioze në mbledhjen e të dhënave për shumicën e treguesve. Shumica e të dhënave janë në dispozicion të publikut në faqet e internetit të institucioneve përkatëse. Ato që nuk ishin në dispozicion u mbledhën me ndihmën e organizatave joqeveritare që punojnë për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve. Për informacione më specifike, qëllimi i organizatës ishte të adresonte një kërkesë për qasje në informacionin publik tek institucioni kompetent që kanë informacion mbi të dhënat që mungonin. Shpesh organizata u has me përgjigje nga institucionet përkatëse që të dhënat specifike për mbrojtjen e fëmijëve nuk regjistrohen ose mblidhen. Gjithashtu, disa nga të dhënat që institucionet kishin nuk na i dhanë pa ndonjë shpjegim.

- Si po funksionon mekanizmi i mbrojtjes së fëmijëve në vendin tuaj?

Mekanizmi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut është zhvilluar shumë deri më tani dhe ende po punon për përmirësimin e tij të mëtejshëm. Në shumicën e institucioneve, mbahen statistika të hollësishme për të dhënat që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve. Sidoqoftë, ende mungojnë një numër i madh i të dhënave si dhe kategorizimi i tyre sipas moshës, gjinisë, etj.

- Cili mund të jetë roli i OShC-ve në përmirësimin e mekanizmit për të drejtat fëmijën?

Roli i shoqëria civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përmirësimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve është vendimtar. Me secilin projekt dhe kritikën publike të shoqërisë civile, u bëjmë presion institucioneve përkatëse për të zhvilluar një sistem të gjerë dhe gjithëpërfshirës të të dhënave që prek të drejtat e fëmijëve. Shoqëria civile ka bërë përpjekje serioze për të përmirësuar sistemin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, por ka përpara një luftë edhe më të madhe në mënyrë që të kontribuojmë në mbledhjen e të dhënave nga institucionet përkatëse për të dhëna sa më specifike që prekin të drejtat e fëmijëve. Vetëm me të dhëna të plota dhe të hollësishme për shkeljen e të drejtave të fëmijëve, sistemi mund të ndikojë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.